



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDIM

Nr. 11, datë 3.7.2019

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË SEANCËS PLENARE DHE KOHËS SË DEBATIT
PËR RAPORTIN E KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN
PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT DHE PROPOZIMIT PËR NGRITJEN
E KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR, PËR SHKARKIMIN NGA
DETYRA TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS Z. ILIR META**

Në mbështetje të neneve 12, dhe 112 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

I. Më datë 8 korrik 2019, ora 18.00 do të mbledhet Kuvendi në seancë plenare për të shqyrtuar raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe propozimit për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar, bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës z. Ilir Meta.

II. Koha e debatit të jetë 2 orë e 10 minuta (130 minuta), nga të cilat 70 minuta kohë për shumicën parlamentare (grupin Parlamentar të Partisë Socialiste dhe deputetët e partive që mbështesin shumicën) dhe 60 minuta kohë për pakicën parlamentare nga të cilat 20 minuta për Grupin Parlamentar Demokrat, 20 minuta për Grupin Parlamentar I Pavarur si dhe 20 minuta për deputetët jashtë grupeve parlamentare.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Gramoz RUÇI

